

REZOLUTË

Kuvendi i Shqipërisë është duke ndjekur në vazhdimësi çështjen e përmirësimeve ligjore për kthimin dhe kompensimin e pronave pronarëve. Këtij qëllimi i ka shërbyer edhe ngritja e Komisionit të Posaçëm për Pronat. Por, nga informacioni që i është bërë Kuvendit dhe nga debati i zhvilluar konstatohet se ka vonesa në hartimin e ligjit përfundimtar për kthimin dhe kompensimin e pronave. Ka pasur gjithashtu, raste të moszbatimit të nenit 3 të ligjit nr.8337, datë 30.4.1998 “Për kalimin në pronësi të tokës bujqësore, pyjore, livadheve dhe kullotave”, për mostjetërsimin e tokave bujqësore, pyjore, livadheve dhe kullotave deri në kompensimin e ish-pronarëve. Në këto kushte, Kuvendi i Shqipërisë kërkon që Komisioni i Posaçëm për Pronat të marrë masat përkatëse për përshpejtimin e hartimit të projektligjit për pronat. Në të njëjtën kohë Kuvendi i kërkon Këshillit të Ministrave dhe organeve të qeverisjes vendore që deri në hartimin e projektligjit të ri të ndërpresë (me përjashtim të rasteve kur vepron ligji që ka të bëjë me shpronësimet publike) tjetërsimin dhe dhënien me qira të pronave shtetërore disponibël.